



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Komisioni për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Mbledhja nr. 01/2011
Prishtinë, më 17. 3. 2011, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla N-225

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri

Në mbledhje morën pjesë: Zenun Pajaziti - kryetar, Teuta Sahatçija, Fikrim Damka, Sala Berisha-Shala, Berat Buzhala, Lutfi Zharku, Hashim Deshishku, Visar Ymeri, Ramiz Kelmendi, Myzejene Selmani, Biserka Kostić.

Pjesëmarrës të tjerë: Besnik Ramadani – KDI dhe Haxhi Gashi – USAID.

Stafi mbështetës i Komisionit: Armend Ademaj, Besim Haliti dhe Muhamet Morina.

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komisionit.

Rendi i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës,
2. Konstituimi i Komisionit,
3. Të ndryshme.

Kryetari - Konstatoi se ishin plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen me pikën e parë të rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Konstituimi i Komisionit

Kryetari - E hapi mbledhjen e parë të Komisionit për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, për Legjislaturën IV, dhe e shpalli të konstituar Komisionin për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri. Theksoi se angazhimet do të jenë në frymën konstruktive për kryerjen e të gjitha punëve që i kemi me fushëveprimin të paraparë me Rregulloren e Kuvendit, ceku shqyrtimin e projektligjeve në fushëveprimin e Komisionit; mbikëqyrjen e zbatimit të ligjeve, mbikëqyrjen resorëve të Qeverisë, që bie në kompetencat e Komisionit dhe angazhimet e tjera. Shtoi se shpreson në një frymë konstruktive të punës ndërmjet anëtarëve të Komisionit. Siguroi se do ta kenë mbështetjen e plotë për bashkëpunim për punën që e pret Komisionin. Po ashtu kërkoi nga anëtarët e Komisionit ta bëjnë të njëjtën gjë.

Teuta Sahatqija - Theksoi se ky është një Komision i rëndësishëm që përfshin shumë fusha dhe do të jetë i ngarkuar, me mbledhje dhe me aktivitet. Është fati i mirë që ka njerëz që kanë përvojë, jo vetëm në fushën e legjislacionit, në qeverisje, por edhe në biznes. Prandaj koha nëpër të cilën po kalon Kosova, është e vështirë, andaj zhvillimi ekonomik duhet të jetë prioritet. Pikërisht ky Komision ka të bëjë më së shumti me zhvillimin ekonomik.

Sala Berisha-Shala - Si deputete e tri legjislaturave dhe anëtare e këtij Komisioni do ta japë kontributin e saj në shërbim të punës sa më të mirë të Komisionit dhe të Kuvendit. Kërkoi që Komisioni të mos bëjë dallime partiake, për shkak ato e pengojnë punën dhe në përgjithësi efektivitetin e Komisionit.

3. Të ndryshme

a) Strategjia legjislative 2011

Kryetari – I njoftoi anëtarët e Komisionit se në Qeveri është miratuar Strategjia legjislative 2011 dhe në mbledhjen e ardhshme do të caktohet një grup pune për hartimin e planit të punës së Komisionit për vitin 2011, sepse pa strategji legjislative nuk mund të hartohet as plani i punës së Komisionit.

Ramiz Kelmendi - Kërkoi që të mbahet një takim lidhur me udhëzimet juridike, që anëtarët e Komisionit të njoftohen si t'i paraqesin propozimet procedurale në aspektin juridik për proceset e mëtutjeshme në Komision dhe në Kuvend.

Teuta Sahatqija - Kërkoi që stafi mbështetës i Komisionit ta hartojë një listë të ligjeve të miratuara deri më tani dhe një liste për ato që parashihen të sillen me Strategji.

Myzejene Selmani - Tha që ky Komision në mandatin e kaluar ka bërë punë të madhe. Por tani me fillimin e kësaj Legjislature duhet t'i presim projektligjet që janë në Strategjinë legjislative për këtë Komision funksional. Edhe një punë tjetër e rëndësishme që na pret është mbikëqyrja e punës së agjencive të pavarura, që i raportojnë këtij Komisioni funksional.

Pas disa diskutimeve Komisioni e nxori këtë

Konkluzion

1. Plani i punës së Komisionit të hartohet pasi që të sillet Strategjia legislative e Qeverisë për vitin 2011;
2. Komisioni të formojë një grup pune për hartimin e Planit të punës së Komisionit për vitin 2011.

b) Çështjet vijuese

Kryetari – Propozoi që mbledhjet e Komisionit në parim të mbahen ditën e hënë, për shkak se është fillimi i javës dhe mund të jemi të gatshëm, që edhe punët e tjera t'i përmbyllim gjatë tërë javës.

Ramiz Kelmendi - Kërkoj që mbledhjet të mbahen ditën e martë, për shkak të angazhimeve të tjera që i kanë deputetët. Propozoj që për mbledhjen ardhshme të caktohet një temë, që është aktuale për tregtinë e Kosovës, siç është marrëveshja për CEFTA-n.

Pas disa diskutimeve Komisioni e nxori këtë

Përfundim

Mbledhjet e rregullta të Komisionit në parim të mbahen ditën e martë.

Mbledhja përfundoi në orën 11:40.

Përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit

Zenun Pajaziti

Kryetari i Komisionit